



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 142/5 Prot

Tiranë më 22 . 04 . 2015

V E N D I M

Nr 34 Datë 22 / 04 / 2015

**Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil ,
në institucionin e Këshillit të Qarkut Shkodër.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", (i ndryshuar); neneve 80-104 të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në institucionin e Këshillit të Qarkut Shkodër,

VËREJ SE:

Në zbatim të vendimit nr. 6, datë 28.01.2015 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionin e Këshillit të Qarkut Shkodër", ka filluar kryesisht mbikëqyrja tematike në institucionin e Këshillit të Qarkut Shkodër.

Objekti i mbikëqyrjes është i kufizuar në institutin e deklarimit të statusit të punësimit për punonjësit e institucionit që kanë qenë në marrëdhënie pune në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil, si detyrim i parashikuar në mënyrë të shprehur në nenin 67 të ligjit "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, në kapitullin që bën fjalë për dispozitat tranzitore.

Mbikëqyrja është zhvilluar në përputhje me programin e mbikëqyrjes me nr. 142/2 prot., datë 28.01.2015, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, dhe i njoftuar institucionit me shkresën nr. 142/1 prot., datë 28.01.2015 "Njoftim për fillimin e mbikëqyrjes".

Në përfundim të këtij procesi, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projekt raportin, dërguar për njohje subjektit të kontrolluar, me shkresën nr.142/3, datë 24.03.2015 "Dërgohet projekt raporti", duke i lënë 5 ditë kohë për të paraqitur observacionet në lidhje me materialin.

Pas kësaj faze procedurale, rezulton se projekt raporti është kthyer pranë Komisionerit, i nënshkruar nga titullari i institucionit dhe nëpunësi përgjegjës për administrimin e burimeve njerëzore në institucion, me shkresën nr. 293/1, datë 30.03.2015 "*Observacion - në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin e Këshillit të Qarkut Shkodër*".

Nga përmbajtja e observacioneve, vërehet se janë paraqitur disa pretendime nga ana e institucionit në lidhje me raste të ndryshme të administrimit të shërbimit civil, të trajtuara në përmbajtjen e projekt raportit, madje duke cituar edhe akte administrative në mbështetje të tyre.

Në lidhje me këtë aspekt, Komisioneri konstaton se pretendimet e institucionit nuk janë shoqëruar me aktet administrative përkatëse, të njehsuara me origjinalin nga institucioni, për t'i provuar ato, ashtu si është kërkuar në shkresën përcjellëse që shoqëron dërgimin e projekt raportit në institucion, ç'ka do të mundësonte pasqyrimin e tyre edhe në tabelat përkatëse, që janë pjesë e raportit të mbikëqyrjes.

Për këtë arsye, Komisioneri vlerëson se këto pretendime nuk do të analizohen në këtë fazë të procesit, e për pasojë edhe nuk do të pasqyrohen në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, për t'u analizuar më tej, në një fazë tjetër të procesit, që ka të bëjë me verifikimin e zbatimit të rekomandimeve, pas përfundimit të afatit që do të vendoset për të rregulluar paligjshmërinë e konstatuar në këtë institucion.

Ndërkohë, nga përmbajtja e observacioneve kemi rënë në dijeni të faktit se institucioni është përfshirë në një proces ristrukturimi dhe për këtë arsye, njësia e burimeve njerëzore duhet të informojë Komisionerin për ecurinë e këtij procesi, duke e njohur me strukturën e re, si dhe me të gjithë procedurën që e ka shoqëruar atë.

Sa më sipër, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, çmon se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, Komisioneri vijoi me shqyrtimin e përmbajtjes së raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës dhe në përfundim të këtij procesi, vlerëson se duhet të miratojë përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, si dhe Rregullores "*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, në institucionin e Këshillit të Qarkut Shkodër, që do të jetë pjesë e këtij vendimi.
2. Njësia Përgjegjëse (Drejtoria e Burimeve Njerëzore), në zbatim të nenit 128 të Kodit të Procedurave Administrative, "*Ndryshimi dhe zëvendësimi i akteve administrative*", të

ndryshojë aktin e deklarimit të statusit të punësimit, për punonjësen ***** , në pozicionin *"Specialiste e Buxhetit dhe Shpenzimeve"* dhe për punonjësen ***** , në pozicionin *"Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Kontabiliteti"*, duke shtuar faktin që punonjësit duhet të konsiderohen në periudhë prove.

Njësia përgjegjëse të marrë masat për të zbatuar të gjitha detyrimet ligjore që parashikohen për punonjësit në periudhë prove, duke përfshirë përfundimin e trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPA), përcaktimin e një punonjësi më të vjetër për t'u kujdesur, si dhe vlerësimin e punës nga eprori dhe pas kësaj, të shprehet për konfirmimin ose jo në këto pozicione.

3. Njësia përgjegjëse, të nxjerrë Aktin e Deklarimit të Statusit të Punësimit për punonjësit e Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, për punonjësin ***** , në pozicionin *"Drejtore të Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës"*, për punonjësin ***** , në pozicionin *"Përgjegjëse e Sektorit të Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës"* dhe për punonjësin ***** , në pozicionin *"Specialist në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës"*.
4. Njësia përgjegjëse duhet të revokojë aktin e deklarimit të statusit si nëpunës civil për punonjësin ***** , duke evidentuar faktin se pozicioni i punës *"Zëdhënës, Këshilltar i Marrëdhënieve me Jashtë"*, nuk futet në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil.

Nëse institucioni pretendon se ky pozicion është pjesë e shërbimit civil, duhet të bëjë njehsimin e këtij pozicioni me emërtesat dhe klasat e nëpunësisë civile.
5. Njësia përgjegjëse duhet të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit, për punonjësit ***** , emëruar me Urdhërin e Brendshëm nr. 1/22, datë 01.02.2001 në pozicionin *"Inspektor Mjedisi"*; ***** , emëruar me Urdhërin e Brendshëm nr. 11, datë 03.02.2009 në pozicionin *"Specialist IT në Sektorin e Shërbimeve të Brendshme"* dhe ***** , emëruar me Urdhërin e Brendshëm nr. 518, datë 01.02.2006 në pozicionin *"Specialiste Arkiv/Protokolli"*, duke evidentuar faktin se nuk i përmbushin kriteret për të qenë nëpunës civilë dhe pozicionet e punës të shpallen të lira për t'u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore.
6. Të sqarohet situata në lidhje me aktin administrativ, *"Urdhëri i Brendshëm, nr. 31, datë 10.12.2014, i Kryetarit të Këshillit të Qarkut"* në lidhje me pezullimin e përkohshëm nga detyra të punonjësve ***** dhe ***** , përkatësisht në pozicionet e punës *"Drejtore"* dhe *"Specialist"* në Drejtorinë e Mbrojtjes dhe Administrimit të Tokës. Në kushtet konkrete, ky akt ka dalë në kundërshtim me ligjin e me procedurat ligjore që rregullojnë institutin e pezullimit, në zbatim të ligjit nr. 152/2013 *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar dhe akteve nënligjore që kanë dalë për zbatim të tij.
7. Drejtoria e Burimeve Njerëzore, duhet të revokojë aktin e emërimit për punonjësin ***** , në pozicionin e punës *"Specialist në Sektorin e Shërbimeve Sociale, Arsimit dhe Shëndetësisë"* dhe të vijojnë procedurat për plotësimin e tij në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore që rregullojnë këtë proces.

8. Njësia përgjegjëse të informojë Komisionerin për ecurinë e procesit të ristrukturimit, duke e njohur me strukturën e re, si dhe me të gjithë procedurën që e ka shoqëruar atë.
9. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative lihet afat **30** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Njësia përgjegjëse, duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në përmbajtjen e raportit.
10. Me kalimin e këtij afati, Këshilli i Qarkut Shkodër duhet të njoftojnë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
11. Për këtë vendim të njoftohet Këshilli i Qarkut Shkodër, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni i Ligjeve në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA